



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport,
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 79

Prishtinë, më 08.05.2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla n-303

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike,
Qeverisje Lokale dhe Media**

Në mbledhje morën pjesë : Idriz Vehapi, Eqrem Kryeziu, Enis Kervan, Ramë Vataj, Xhevahire Izmaqi, Lirije Kajtazi, Sadri Ferati, Teuta Haxhiu, Jeton Svirca dhe Milivoje Stojanovic, ndërsa mungoi: Afrim Kasolli.

Në mbledhje morën pjesë: Hatmane Lufi – MAP dhe Bajram Ajeti – Kryetar i KPMSHC-së
Nga stafi mbështetës i komisionit: Shaip Goxhuli dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi, Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2012;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Idriz Vehapi - njoftoi anëtarët e komisionit që, Qeveria e Kosovës i raporton Kuvendit të Kosovës, një herë në vit, në bazë të nenit 6 të Ligjit për Shërbimin Civil, pastaj ia dha fjalën përfaqësueses së MAP-së.

Hatmane Lufi – duke cekur se raporti për vitin 2012 është i përfunduar, por ende nuk është përcjell në Kuvend, ajo tha se raporti të cilin po e shqyrtojmë, është raport i vitit 2011 dhe është raporti i parë të cilin departamenti e ka hartuar në bazë të funksioneve dhe obligimeve të përcaktuara me rregulloren e Qeverisë.

Meqë, nuk kemi bazë të të dhënave për menaxhimin e informatave të burimeve njerëzore për shërbimin civil të Kosovës, d.m.th na mungon regjistri civil për menaxhimin e informatave që është një hendikep dhe na sjell vështirësi për të hartuar një raport.

Enis Kervan - pyeti, a ka progres në rritjen e 10% të nëpunësve civil nga radhët e komuniteteve, pasi që kjo është e përcaktuar me ligjin për shërbimin civil?

Hatmane Lufi - në bazë të Raportit të vitit 2012 i cili është në përfundim ka rritje të numrit të nëpunësve civil dhe kjo rritje është në favor të barazisë gjinore.

Teuta Haxhiu – duke deklaruar se nuk do ta votojë Raportin e vitit 2011, ajo pyeti lidhur me komunikimin në mes të MAP dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal në kontekst të shqetësimeve që ajo kishte vërejtur gjatë monitorimit, nga komisioni funksional, të Ligjit për shërbimin civil, rreth rregulloreve të komunave për shërbimin civil.

Hatmane Lufi - u përgjigj, se shërbimi civil në nivel komunal i nënshtrohet Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Xhevahire Izmaku – pyeti lidhur me mungesën e data bazës, regjistrit qendror?

Hatmane Lufi - tha se fjala është për mungesën e regjistrit civil qendror për menaxhimin e informatave, duke e njoftuar se në mbështetje të bankës botërore, MAP ka filluar të zhvillojë regjistrin qendror të të dhënave për shërbimin civil të Kosovës i cili do të përfundojë në fund të vitit 2013.

Eqrem Kryeziu –lidhur me rritjen e numrit të shërbyesve civil në institucione në përgjithësi, pyeti pikërisht për reformimin e administratës publike?

Hatmane Lufi – tha se kjo çështje është e rregulluar me miratimin e rregullores për përkrahimin e vendeve të punës së shërbyesve civil.

Sadri Ferati – sipas statistikave në asnjë institucion qendror e lokal, nuk ka analizë lidhur me sistemimin e vendeve të punës që përafërsisht e ngarkojnë njëjtë një zyrtar dhe mbi këtë bazë, cila duhet të jetë arsyeja që të inicohet një debat lidhur me çështjen se cila është Kosova dhe administrata shtetërore, sikur kishte me u organizu një tryezë e tillë kuptohet me ndihmën e ekspertëve, kishte me qenë puna më e madhe që kishte me e pasur komisioni.

Idriz Vehapi - duke konkluduar se gjendja në shërbimin civil nuk është e mirë dhe duke kërkuar nga përfaqësuesja e MAP-së që në Raportin e vitit 2012 të raportohet në detaje për të gjitha rregulloret e nxjerra nga Ligji për shërbimin civil.

Ai ftoi anëtarët e komisionit që të deklarohen me votë për miratimin dhe procedimin e Raportit për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Konstatim – Komisioni me shumicë votash “Për”, 1 “Kundër”, miratoi Raportin e Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2011.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

Arsyetimi

Në bazë të nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës i raporton Kuvendit të paktën një herë në vit për gjendjen në shërbimin civil.

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 08.05.2013, shqyrtoi Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2011 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2012;

Idriz Vehapi - njoftoi anëtarët e komisionit që, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës i raporton Kuvendit të Kosovës, një herë në vit, në bazë të nenit 19.1 të Ligjit për KPMSHCK, pastaj fjalën ia kaloi deputetit,

Jeton Svirca - i cili pyeti kryetarin e KPMSHCK-së, se a është miratuar raporti vjetor nga anëtarët e Këshillit?

Bajram Ajeti – u përgjigj, po, është miratuar raporti dhe këtë e dëshmoi me procesverbalin dhe vendimin e nxjerre nga Këshilli për miratimin e raportit.

Ai tha se, në bazë të kushtetutës dhe Ligjit për KPMSHCK, Këshilli ka tri funksione: shqyrtimin e ankesave të shërbyesve civil, monitorimin e zbatimit të ligjit dhe vëzhgimin e përzgjedhjes së nëpunësve civil në institucione të Kosovës. Gjatë vitit 2012, Këshilli ka përmbushur funksionet duke cekur se funksionin për monitorimin e ligjit për shërbimin civil nuk e ka monitoruar plotësisht në terren për arsye të kufizimit të kohës dhe të numrit të madh të institucioneve.

Idriz Vehapi - duke cekur se po përsëriten problemet, shqetësimet e njëjta nga Këshilli, ai tha, se shpreson që të gjithë nëpunësve civil, pa asnjë dallim, t'ju jepet përkrahje e drejtë dhe e paanshme ligjore.

Teuta Haxhiu - pyeti, kryetarin e KPMSHCK-së – se e a është në dijeni për veturën të cilën shefja ekzekutive e KPM-së ia ka dhuruar si donacion KPMSHCK-së dhe që pronar i veturës është njëri nga anëtarët e Këshillit dhe pyetje tjetër lidhur me vendimin e Këshillit, me të cilin vendim një drejtor i një shkolle ishte i titulluar si shërbyes civil deri sa sipas ligjit për shërbimin civil drejtorët e shkollave nuk janë shërbyes civil?

Bajram Ajeti - u përgjigj: sipas nenit 4 të Ligjit për shërbimin civil është e përcaktuar se kush nuk është shërbyes civil, ndërsa sa i përket pyetjes lidhur me veturën, ai tha se qëndron fakti se kemi pranuar një veturë donacion nga KPM dhe ka një memorandum dhe që pronar është Këshilli i Pavarur, por nuk qëndron fakti se ju ka dorëzuar ndonjë zyrtari apo se ndonjë zyrtar është pronar i veturës.

Ramë Vataj - falënderoi kryetarin e KPMSHCK-së për prezantimin e raportit dhe pyeti lidhur me mospajtimet në arsim dhe shëndetësi në mes stafit dhe drejtorëve, statusin e tyre?

Lirije Kajtazi - pyeti, sa është numri i ankesave, që gjykatat i kanë kthyer për rishqyrtim në KPMSHCK?

Bajram Ajeti – gjykata nuk kanë anuluar asnjë Vendim të Këshillit përveç që i kanë kthyer për rishqyrtim.

Milivoje Stojanovic - pyeti se a është mbikëqyr puna në Komunën e Parteshit nga KPMSHCK dhe pse janë në listë të pagave arsimtarët e shkollës në të njëjtën komunë të cilët nuk vijnë punën?

Bajram Ajeti - se cilat komuna janë monitoruar, janë të cekura në faqen 21 të Raportit ndërsa sa i përket listës së pagave për arsimtarët e shkollës kjo është pyetje për MAP, ngase shërbyesit publik nuk i nënshtrohen Ligjit për KPMSHCK, por Ligjit të Punës.

Idriz Vehapi – ftoi anëtarët e komisionit që të deklarohen me votë për miratimin dhe procedimin e Raportit për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Konstatim – Komisioni votoi unanimit, për miratimin e Raportit të KPMSHCK-së dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqet këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2012.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

Arsyetimi

Në bazë të nenit 19 të Ligjit nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ia paraqet raportin vjetor të punës Kuvendit të Kosovës.

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 08.05.2013, shqyrtoi Raportin vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2012 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 19 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

4. Të ndryshme.

Ramë Vataj - duke shprehur shqetësimin e tij lidhur me nxjerrjen e një udhëzimi administrativ nga Ministri i Arsimit, rreth reformimit të Fakultetit të Edukimit, ai kërkoi që Ministri i Arsimit të ftohet në komision.

Idriz Vehapi – duke i njoftuar anëtarët e komisionit se me Vendimin e Kryesisë së Kuvendit, e cila pasi ka shqyrtuar Vendimin e Qeverisë për themelimin e tri universiteteve, komisioni është i ngarkuar për të shqyrtuar çështjen e themelimit të tri universiteteve dhe lidhur me këtë pyeti anëtarët e komisionit për mbajtjen e mbledhjes së radhës në të cilën do të jetë për shqyrtim çështja në fjalë dhe që komisioni të dal me rekomandim.

Mbledhja përfundoi në ora:13:30

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**KRYETARI I KOMISIONIT,
Idriz Vehapi**